



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 07.06.2023

Nr: 176

Ora: 10:55

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËSAVE ANKIMORE NR. 81 DHE NR. 86, TË DEPOZITUARA NGA “PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT” DHE KOALICIONI “BASHKË FITOJMË”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 07.06.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

- ANKUES 1:** Subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga z. Franci Nuri dhe z. Arjan Hoxha.
- ANKUES 2:** Subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”, përfaqësuar nga z. Redi Ramaj dhe nga z. Nazi Sulaj.
- PALË E INTERESUAR:** Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Maringlen Legisi dhe z. Andi Skënderi

OBJEKT:

1. Kundërshtim i vendimit nr. 536, datë 20.05.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë në zonën zgjedhore bashkia Kamëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”;

2. Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kërkon pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore bashkia Kamëz;

3. Subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit” kërkon rinumërim dhe rivlerësim të votave të vlefshme dhe të pavlefshme në kutitë e votimit për këshill për QV 1575 dhe 1597/02 dhe ndryshimin e tabelës për rezultatin për këshillin bashkiak Kamëz duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga procesi i numërimit dhe vlerësimit të votave.

BAZË LIGJORE:

Nenet 123/1 dhe pika 3 e nenit 124 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Në datën 14.05.2023, në 61 bashki në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse kanë plotësuar dhe miratuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për kryetarët e bashkive dhe për këshillat bashkiakë.
2. Zona zgjedhore Kamëz ka 2 (dy) zona të administrimit zgjedhor, përkatësisht ZAZ nr. 27 dhe ZAZ nr. 28. Këto KZAZ kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, tabelat përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Kamëz dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kamëz.

3. Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve si për Kryetarin ashtu dhe për Këshillin, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të çdo QV-je të zonës përkatëse, përveç rezultatit të QV-së nr. 1575/00 dhe 1597/02 në ZAZ-në nr. 27, sepse me vendim të KZAZ-së nr. 27, kutia me fletë votimi për Këshillin dhe për Kryetarin janë shpallur kuti të parregullta.
4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kamëz dhe për Këshillin e Bashkisë Kamëz me vendimin nr. 536, datë 20.05.2023, "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".
5. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore koalicioni "Bashkë Fitojmë", përfaqësuar nga z. Franci Nuri dhe kandidati për kryetar bashkie i koalicionit, z. Arjan Hoxha të cilët pretendojnë se gjatë procesit zgjedhor në përfundim të të cilit është marrë ky vendim, kanë ndodhur shkelje të ligjit që kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor, në një masë të tillë që kanë ndikuar në rezultatin final.
6. Subjekti ankues parashtron në kërkesën ankimore se:
 - Me anë të Pajisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN) është programuar paraprakisht rezultati i zgjedhjeve vendore, duke patur raste të vonesave të pashpjegueshme në kohë të kryerjes së procesit të votimit elektronik kur votohej për kandidatin e BF, Arjan Hoxha; ka patur raste të moskryerjes deri në fund të procesit të votimit pasi nuk është marrë komanda 'printo'; ka patur raste kur është votuar për numrin rendor '3' dhe fleta e votimit është printuar me numrin rendor '1';
 - Operatorët e caktuar në Qendrat e Votimit janë përzgjedhur në kundërshtim me ligjin, duke u zgjedhur persona të cilët ishin në marrëdhënie pune me kandidatin që kandidon në atë zonë zgjedhore;
 - Është konstatuar shoqërimi i votuesve nga ana e komisionerëve, operatorëve të QV-ve ose punonjësve të administratës vendore dhe qendrore, të cilët kanë votuar në emër të tyre;

- Kur votuesi është shoqëruar për të votuar, në shumicën e rasteve nuk janë nënshkruar deklaratat përkatëse sipas Kodit Zgjedhor;
- Është konstatuar shoqërimi i disa personave nga i njëjti shoqërues;
- Mosfunksionimi deri në tre orë i pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve (PEI) ka ndikuar në largimin e një numri të madh zgjedhësish që nuk kanë votuar;
- Në listat përfundimtare të zgjedhësve, është bërë ndryshimi i qendrave të votimit pa asnjë arsye, krahasuar me zgjedhjet pararendëse, duke ndarë të njëjtën familje në dy qendra votimi, pavarësisht adresës së njëjtë të banimit;
- Ankuesi pretendon se ka patur raste intimidimi dhe presioni të votuesve;
- Janë kryer punime nga bashkia Kamëz gjatë periudhës së fushatës, pa u kryer asnjë procedurë prokurimi publik; janë shpërndarë leje legalizimi deri një natë para ditës së zgjedhjeve; janë kryer emërime tre mujore pak ditë para ditës së zgjedhjeve;
- Ankuesi pretendon se ka mospërputhje midis numrit të votave për kandidatët për kryetar bashkie me votat për këshillin bashkiak, ku rezultojnë 46.746 vota për kryetar dhe 46.494 vota për këshillin bashkiak.

7. Bashkëlidhur kërkesës ankimore nr. 81 të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” gjenden foto si më poshtë:

- Foto ku duket drejtori i shkollës “100 vjetori” z. Rasim Beluli, në ambientet e qendrave të votimit që ndodhen në këtë shkollë, ku sipas ankuesit drejtori ka shoqëruar votues për të kontrolluar dhe orientuar votat e tyre;
- Foto ku duket nënkryetarja e bashkisë Kamëz, ku ankuesi pretendon se znj. Migena Habibi ka shoqëruar votuesit deri te kutitë e votimit;
- Foto e një zyre elektorale të kandidatit të PS, z. Rakip Suli, ku ankuesi pretendon se ndodhet shumë afër qendrës së votimit;

- Foto nga qendra e votimit nr. 2041/1, ku ankuesi pretendon se duket një përfaqësues i PS, i ulur në një pozicion të tillë sa komunikon me votuesit dhe është në gjendje të shohë se për cilin kandidat voton, përmes biletës së printuar brenda në kuti;
 - Foto nga hyrja e kopshtit nr. 12 “Topolino”; Foto nga qendrat e votimit në shkollën “Elez Isuf Ndreu”, ku ankuesi pretendon se punonjës administrate kanë ndenjur gjatë gjithë ditës së votimit dhe kanë shoqëruar punonjësit deri në dhomat e votimit;
 - Në QV nr. 1577 pretendojnë raste të votimit kolektiv;
 - Foto nga QV nr. 2051 ku ankuesi pretendon se operatorja është fotografuar teksa është prezente në momentin e votimit nga një qytetar duke i shkelur të drejtën e votimit të fshehtë;
8. Kundër vendimit nr. 536, datë 20.05.2023 të KSHZ-së ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit” ku pretendon se:
- Në Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për këshillin e bashkisë Kamëz nuk janë përfshirë rezultatet e dy qendrave të votimit, përkatësisht QV nr. 1575 dhe 1597/02;
 - Në librat e protokollit nuk është shënuar arsyeja se përse këto QV janë hequr nga rezultati përfundimtar;
 - Duhet të kryhet hetim i thelluar për QV nr. 1575 dhe 1597/02, të cilat janë shpallur të pavlefshme dhe të kryhet numërimi dhe vlerësimi i votave të vlefshme dhe të pavlefshme, duke u përfshirë në rezultatin përfundimtar.
9. Subjekti ankues, koalicioni “Bashkë Fitojmë” paraqiti këto kërkesa:
- kërkesë për vënien në dispozicion të të gjitha regjistrimeve video të kamerave vëzhguese të QV-ve për zonën zgjedhore Kamëz, pasi i janë vënë në dispozicion vetëm një pjesë e tyre;
 - kërkesë për informacion lidhur me pajisjet PEVN dhe sistemin e ruajtjes së të dhënave (shkresa nr. 5457 prot., datë 25.05.2023)

- kërkesë për caktimin e një eksperti të huaj, të certifikuar ndërkombëtarisht, i cili të bëjë ekspertimin e çdo pajisjeje elektronike të pajisur me server për ruajtjen e të dhënave elektronike. Kërkesa u modifikua në seancën e datës 06.06.2023 dhe ankuesi kërkoi përfundimisht që t'i viheshin në dispozicion 10 pajisje PEVN, me qëllim që me ekspertët e vet të verifikonte Log-et e pajisjes.

Kërkesa për vënien në dispozicion të regjistrimeve të kamerave vëzhguese dhe kërkesa për informacion u plotësuan nga administrata e KQZ-së, për aq sa ishte e mundur, jashtë procedurës së shqyrtimit të ankimit. KAS-i i dha ankuesit “Bashkë Fitojmë” kohën e nevojshme, me qëllim që të këqyrte regjistrimet video dhe të qëmtonte tek to provat në mbështetje të kërkesës ankimore.

Informacioni lidhur me pajisjet PEVN dhe sistemin e ruajtjes së të dhënave iu dorëzua ankuesit në datën 06.06.2023. Në seancën e datës 07.06.2023 ankuesi nuk e depozitoi si provë këtë dokumentacion dhe nuk lidhi kërkime të tjera me të.

Kërkesa për vënien në dispozicion të 10 pajisjeve PEVN u rrëzua për shkak se qëllimi për të cilin kërkoheshin ato, verifikimi i Log-eve, nuk vërteton dot pretendimin për manipulim të programit me qëllim falsifikimin e rezultatit.

6. Kërkesat ankimore nr. 81, datë 23.05.2023 dhe nr. 86, datë 25.05.2023 iu paraqitën KAS-it, i cili në seancë paraprake vendosi pranimin dhe shqyrtimin e tyre bashkërisht me relator z. Elvin Lako. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 31.05.2023, ora 15:00. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj; përfaqësuesit e palës ankimuese koalicioni “Bashkë Fitojmë” z. Franci Nuri dhe z. Arjan Hoxha; përfaqësuesit e subjektit ankues “Partia Lëvizja e Legalitetit”, z. Redi Ramaj dhe z. Nazi Sulaj si dhe përfaqësuesit e palës së interesuar “Partia Socialiste e Shqipërisë” z. Maringlen Legisi dhe z. Andi Skënderi.

7. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën ankimore nr. 81, datë 23.05.2023 të depozituar nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”;
- Kërkesën ankimore nr. 86, datë 25.05.2023 të depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”;

- Vendimin nr. 536, datë 20.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezulttit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore bashkia Kamëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”
- Fotot dhe pamjet filmike të depozituara në cilësinë e provës nga subjekti ankues koalicioni “Bashkë Fitojmë”;
- Kutitë e votimit dhe të materialeve zgjedhore të QV nr. 1575 dhe 1597/02
- Librin e Protokollit të KZAZ nr.27 dhe KZAZ nr. 28

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Procedura e votimit dhe ajo e numërimit të votave janë procedura transparente dhe të dokumentuara në çdo hap. Kodi Zgjedhor është kujdesur që ato të zhvillohen në sytë e përfaqësuesve të subjekteve, vëzhguesve të pavarur dhe të publikut, si dhe çdo problem, parregullsi apo shkelje e ligjit të dokumentohet në procesverbalet tip dhe librat e protokollit të komisioneve përkatëse, si dhe të filmohet nga kamerat mbikëqyrëse të procesit, me qëllim që të shërbejë si provë materiale në proceset eventuale për kundërshtimin e rezulttit apo të zgjedhjeve në tërësi.
2. Dokumentacioni që prodhohet nga administrata zgjedhore gjatë zbatimit të procedurave të votimit dhe të numërimit të votave bën pjesë në radhën e parë dhe kryesore të provave ku mund të mbështeten kërkesat ankimore me objekt ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezulttit në një apo disa qendra votimi. Subjektet zgjedhore kanë akses mbi këtë dokumentacion, në disa raste disponojnë *ipso lege* kopje të tij. Nga ana tjetër, Kodi Zgjedhor u njeh palëve edhe të drejtën për të vënë në lëvizje KQZ-në për marrjen e provave *“për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të*

siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre”.

3. Pika 1, e nenit 82 të Kodit të Procedurave Administrative saktëson: *“në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tij”.* Këtë detyrim e vendos edhe Kodi Zgjedhor nëpërmjet shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 136, kur u kërkon palëve *“të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre”.*
4. Kodi Zgjedhor kërkon në mënyrë të shprehur që pretendimet të jenë të mbështetura në prova, sepse Kodi kërkon që t’i presë rrugën e suksesit kërkimeve të pathemelta ose me ves. Kjo do të thotë, se Kodi kërkon që raporti midis pretendimit dhe provës të jetë i drejtpërdrejtë, thënë ndryshe, prova duhet të shërbejë për të mbështetur drejtpërdrejt pretendimin. Pika 4 e nenit 136 të Kodit Zgjedhor saktëson, se *“KQZ-ja mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara”.* Nga ana tjetër, kjo do të thotë se në raportin midis provës dhe pretendimit, prova vjen e para. Provat ekzistojnë përpara pretendimit, nuk krijohen për shkak të tij.
5. Ankuesi ka kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore. Pavlefshmëria e zgjedhjeve është mjet ligjor në duart e subjekteve ankuese, i cili mundëson anulimin e votimit/rezultatit dhe përsëritjen e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit. Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si shkaqe për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve:
 - a) shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;
 - b) fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose

c) mosfillim i votimit apo pezullim i tij për më shumë se pesë orë.

6. KAS-i e ka trajtuar gjerësisht analizën ligjore për kërkimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në vendimarrjen e tij për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 (p.sh. vendimet nr.89, datë 20.05.2021, nr. 91, datë 27.05.2021, nr. 94, datë 31.05.2021, nr. 95, datë 31.05.2021 etj.) Në këto vendime, KAS-i ka arsyetuar, se neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit (p.sh. cënimi i integritetit të kutive të votimit - nenet 115 dhe 138 të KZ). Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”. **Shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur.** Votimi familjar p.sh. që është konstatuar shpesh nga misionet vëzhguese të OSBE/ODIHR-it si shkelje e procesit zgjedhor nuk është konsideruar nga ata kurrë si shkelje që shkakton pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sepse ata nuk e kanë vëzhguar asnjëherë këtë shkelje në masën e vet kritike. Po kështu shitblerja e votës, që gjithashtu është kritikuar në një numër zgjedhjesh, nuk është vëzhguar prej tyre në masë kritike.
7. KAS-i ka vlerësuar se masa kritike është kriteri kyç në gjykimin e kërkesave për pavlefshmëri të zgjedhjeve. Masa kritike ndryshon nga një vend në tjetrin, nga një demokraci në tjetrën, sepse masa kritike varet tërësisht nga shkalla e zhvillimit demokratik. Në çdo demokraci qëllimi është zhvillimi i zgjedhjeve dhe legjitimitimi i pushtetit nga populli. Masa kritike është instrumenti që mbron zgjedhjet dhe demokracinë nga deligjitimitimi.
8. KAS-i ka analizuar se Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore mbrojtëse të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre, mjete ligjor mbrojtës është gjoba administrative (shkeljet e kryera nga media, subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e institucioneve), për një pjesë janë masat disiplinore (shkarkimi etj.), për një pjesë është ndjekja penale (shitblerja e votës, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje etj.), por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo

më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri. Kjo është arsyeja pse kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik, që vërteton se shkelja e pretenduar është “shkelje që cënon rëndë procesin zgjedhor”, sikurse duhet të shoqërohen edhe me provën se sa dhe si e ka cënuar ajo procesin zgjedhor. Nevoja për provueshmëri imponon edhe nevojën për të provuar lidhjen shkakësore midis shkeljes dhe pasojës së rëndë, pengimit/largimit të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrimit të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, ose tjetërsimit në masë të votës së hedhur.

9. Kodi Zgjedhor lejon si shkak për pavlefshmërinë edhe një tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Në dallim nga shkakun themelor, ky rast kërkon më shumë se sa një shkelje, me një shkallë më të ulët cënimi. Në këtë rast nuk duhet që të ketë pasur pengim/largim të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrim të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, apo tjetërsim në masë të votës së hedhur, por mjafton që ky fenomen (pengimi/largimi i zgjedhësve nga votimi, detyrimi për të votuar kundër vullnetit, apo tjetërsimi i votës) të ketë ndodhur në atë shkallë, sa të mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve. Edhe në këtë rast, kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik pse shkelja e pretenduar është “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve”, si dhe me provën për përmasën e ndikimit dhe lidhjen shkakësore.
10. KAS-i ka kërkuar që argumentet për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve të jenë konkrete, të faktueshme, të provueshme dhe të matshme. Këto kërkesa që burojnë nga dispozita e pikës 1 të nenit 160 të Kodit Zgjedhor janë konfirmuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese dhe zgjedhore shqiptare. Vendimi nr.75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese, i cili mund të shërbejë si bazë për të identifikuar metodologjinë për saktësimin dhe konkretizimin e termit “shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor”, kërkon që arsyetimi juridik i KAS-it të kalojë nëpërmjet “përcaktimit të kriterëve, koncepteve bazë si dhe parimeve mbi të cilat duhet të mbështetet organi kompetent për të konkluduar lidhur me aplikimin e shkakut të përshtatshëm kushtetues”. Shkeljet që cënojnë rëndë procesin zgjedhor duhet të jenë shkelje të tilla që e bëjnë të pavlerë rezultatin e

tyre, sikurse “aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën... (duhet të jenë të tilla që) e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese” për zyrtarin e lartë.

11. KAS-i, në shqyrtimin e kërkesave për pavlefshmëri është udhëhequr nga jurisprudenca e Kolegjit Zgjedhor, i cili është marrë posaçërisht me interpretimin e pikës 1 të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, sipas tekstit që është sot në fuqi, në vendimin e tij nr.45, datë 18.11.2013. Kolegji ka konfirmuar karakterin përjashtimor të rasteve të pavlefshmërisë dhe përsëritjes së zgjedhjeve. Sipas Kolegjit Zgjedhor **“përsëritja e zgjedhjeve nuk mund të kryhet për çdo shkelje të evidentuar, qoftë kjo edhe lidhur me parimet e zgjedhjeve, përveçse kur provohet se shkeljet janë të tilla që kanë ndikuar në rezultatin final”**. Kolegji Zgjedhor çmon se nuk mjafton që të provosh se janë kryer shkelje që kanë cënuar procesin zgjedhor për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve, por **duhet të provosh se “këto shkelje të jenë në një masë të tillë sa të mund të kenë ndikuar në ndarjen e mandatit”**. Gjithashtu, Kolegji ka saktësuar se **pretendimi se shkelja “përbën fenomen masiv, ndaj edhe mund të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve” duhet të provohet në gjykim, përndryshe ngelet në kuadrin e një hipoteze dhe nuk mund të merret për bazë nga gjykata**.

12. Ankuesi “Bashkë Fitojmë” ka pretenduar në kërkesën ankimore dhe shqyrtimin e ankimit, se pajisjet PEVN kanë qenë të rakorduara që të shtrembëronin vullnetin e votuesve. *“Një në tri vota të hedhura për kandidatin e ankuesit, janë llogaritur nga pajisja në favor të kandidatit të Partisë Socialiste”*, sqaroi kandidati i “Bashkë Fitojmë” në seancë, *“përndryshe nuk mund të shpjegohet fitorja e papritur”*. Ankuesi nuk dispononte prova për këtë pretendim, por e mbështeste atë në *“arsyetimin llogjik”*, se diferenca ka qenë më e madhe midis dy kandidatëve, në QV-të me mbështetje tradicionalisht më të lartë për kandidatin e “Bashkë Fitojmë”. Nga ana e administratës së KQZ-së u sqarua lidhur me këtë pretendim, se mundësia që pajisjet të kryejnë tjetërsimin e votës është zero. *“Pajisjet nuk mund të regjistrojnë një votë në favor të njërit kandidat dhe t’u printojnë atë në favor të kandidatit tjetër”*, sqaroi drejtoresha e departamentit IT të KQZ-së. Numërimet e votave fizike për bashkitë Kamëz dhe Elbasan që u kryen përgjatë shqyrtimit të kërkesave ankimore për këto bashki dhanë rezultat 100% të përputhshëm në të gjitha rastet ku u krye ky verifikim, si për kandidatët për kryetar bashkie, ashtu dhe për këshillin bashkiak.

13. Ankuesi kërkoi nga KAS-i që të angazhonte ekspert ndërkombëtar për të vertetuar pretendimet e tij lidhur me votimin elektronik, duke anashkaluar parimin e “barrës së provës” që e ngarkon atë me sigurimin e kësaj ekspertize. Për më tepër, pretendimi, duke qenë i natyrës penale, i kapërcen kufijtë, mjetet dhe garancitë që i përkasin hetimit administrativ. Ankuesi e modifikoi kërkesën në seancën e fundit të shqyrtimit administrativ në kërkesë për të pasur akses mbi 10 pajisje PEVN, të përzgjedhura prej tij, me qëllim që të verifikonte me ekspertët e vet regjistrimet Log të pajisjeve. KAS-i e rrëzoi kërkesën, sepse verifikimi i regjistrimit Log jep të dhëna për përdorimin e pajisjes gjatë ditës së votimit, por jo të dhëna se si është votuar, duke e bërë të pavlefshëm këtë kërkim prove për të mbështetur pretendimin.
14. Vendimi i Rregullatorit nr. 04, datë 13.11.2020, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë” përcakton në shkronjën “k” të pikës 10 të tij, se *“votuesit duhet t’i mundësohet verifikimi dhe konfirmimi i çdo zgjedhjeje të bërë, përfshirë dhe konfirmimin e verifikimit të versionit fizik të votës, si dhe kutia të mundësojë për aq sa është e mundur, fotografimin e votës”*. Ankuesi ngriti pretendimin se ky kusht teknik është anashkaluar në zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Pajisjet nuk lejonin konfirmimin e votës fizike. Pas konfirmimit të votimit elektronik, vota printohej dhe bëhej e shikueshme në dritaren e printerit për 5 sekonda dhe pastaj binte në kuti, pa i dhënë mundësinë zgjedhësit që të anulonte në këtë fazë votimin. Ky fakt u pranua edhe nga administrata e KQZ-së dhe u justifikua me shpjegimin, se votimi për dy organe të qeverisjes vendore dhe operimi në një votim me dy vota fizike e bëri të pamundur, për pamjaftueshmëri kohore, modifikimin e nevojshëm në programimin e pajisjes.
15. Ankuesi pretendoi se operimi në kushte paligjshmërie i pajisjes ka eliminuar një nga garancitë e procesit zgjedhor, që është e drejta e zgjedhësit për të modifikuar në çdo kohë vullnetin, deri në momentin e hedhjes së votës në kutinë e votimit, si dhe ka krijuar pabarazi midis votuesve me votim elektronik dhe atyre me votim manual. Ankuesi nuk argumentoi pse kjo paligjshmëri duhet të formojë shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në gjithë zonën zgjedhore. Gjithsesi, KAS-i duhet t’a analizojë këtë fakt në kontekstin e kërkimit për pavlefshmëri dhe të japë përgjigje. Në këtë analizë, KAS-i duhet të udhëhiqet nga arsyetimi i tij themelor, i trajtuar edhe në rastet e tjera, sipas të cilit shkelja duhet të analizohet në kontekstin e dëmit që i ka sjellë procesit (për

më shumë shih vendimet nr.89, datë 20.05.2021, nr. 91, datë 27.05.2021, nr. 94, datë 31.05.2021, nr. 95, datë 31.05.2021 etj.) Midis shkeljes dhe pasojës që sjell ajo duhet të ketë gjithmonë një masë kritike, e cila formon kufirin ndarës midis shkeljes dhe parregullsisë, sporadike, të izoluar, të pjesshme, të përsëritur, të përhapur, të kryer pa dashje ose me qëllim dhe shkeljes që pengon/largon zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyron ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërson në masë votën e hedhur.

16. Në rastin konkret, KAS-i e sheh shkeljen kryesisht tek mospërfshirja e Rregullatorit në zgjidhjen që i është dhënë vështirësisë teknike operative. Nëse Rregullatori do të kishte qenë i përfshirë dhe do të kishte modifikuar, për këto zgjedhje, vendimin nr. 04, datë 13.11.2020, atëherë palët e interesuara do të kishin patur mundësinë të ankoheshin ndaj vendimarrjes së Rregullatorit. E drejta e ankimit ndaj akteve të administratës publike është e drejtë thelbësore. Në këtë rast, palët që kanë patur një interes të ligjshëm nuk janë lejuar t'a mbrojnë interesin e tyre, por janë vënë përpara faktit të kryer.
17. Që KAS-i të vendosë pavlefshmërinë e zgjedhjeve, për shkakun e mësipërm, duhet që ankuesi të provojë se zgjedhësve u është hequr një garanci ligjore, e cila ka kondicionuar masivisht sjelljen e votuesve dhe i ka penguar masivisht në ushtrimin e lirë të vullnetit të tyre. Ankuesi duhet të provonte, se e drejta për të korrigjuar shprehjen e vullnetit, sa kohë që nuk është mbyllur procedura e votimit, është e drejtë e cila përdoret masivisht në zgjedhje, se ajo është vijë sjelljeje e votuesve shqiptarë dhe se provohet si e tillë nga statistika zgjedhore dhe numri i lartë i votave të dëmtuara, në rastet e votimit manual. Ky do ishte korrelacioni që kërkon Kodi dhe jurisprudenca zgjedhore midis shkeljes së sipërcituar dhe pasojës që çon në pavlefshmëri zgjedhjesh. Ankuesi nuk e prezantoi para KAS-it një provë të tillë, ndoshta për shkak të faktit se praktika zgjedhore shqiptare nuk ia jep këtë mundësi.
18. Pretendimi për cenim të barazisë midis votuesve me votim elektronik dhe me votim manual, për shkak të kësaj diferencë nuk formon dot shkak për pavlefshmëri zgjedhjesh. Midis votimit manual dhe atij elektronik ka dallime, të cilat vijnë për shkak të mënyrës së ndryshme të votimit. Heqja e mundësisë së anulimit të votës fizike nuk është i vetmi dallim. Për më tepër, **heqja e mundësisë së anulimit është bërë për nevojat e realizimit të procesit, jo për nevoja të**

manipulimit të tij. Nëse nuk do ishte bërë kjo zgjidhje kompromisi, mund të mos ishte realizuar dot votimi elektronik.

19. Ankuesi paraqiti me cilësinë e provës 70 materiale video (1 material nuk është përfshirë se rezulton qartë se është dhënë dy herë). Materialet i përkasin qendrave të votimit 1577/1, 1581/2 dhe 2040. Në tërësi vlera provuese e materialeve nuk është në nivelin që kërkon një hetim penal (provë jashtë çdo lloj dyshimi të arsyeshëm), por për hetimin administrativ materiali video është i pranueshëm për administrim.
20. Pretendimi se “*operatori shkon te monitori kur nuk ka votues*” është ngritur në 11 raste. Ankuesi nuk ka dhënë shpjegim se pse afrimi i operatorit tek pajisja formon shkelje të ligjit. Rregullat e punës kërkojnë që operatorit të rizgjojë pajisjen, kur ajo kalon në *standby* nga mospërdorimi. Për më tepër, mbikëqyrja e pajisjes është detyrë dhe përgjegjësi e operatorit. Të 11 rastet e kësaj natyre nuk mund të formojnë shkelje.
21. Pretendimi se “*operatori ka votuar për të tjerë*” është ngritur në 5 raste. Pamjet video nuk provojnë se operatorit të ketë votuar për të tretët, Rregullat nuk ia lejojnë operatorit të përfshihet në procedurën e votimit të asistuar, por rregullat i kërkojnë operatorit që të asistojë zgjedhësit kur kryejnë procedurat e votimit elektronik. Përgjatë këtij procesi operatorit është i detyruar të respektojë fshehtësinë e votimit. Respektimi i fshehtësisë së votimit nuk mund të konsiderohet i plotësuar vetëm me ushtrimin e vetkontrollit nga ana e operatorit. Nuk mjafton që ai vetë të ketë ndërgjegjen e qetë, se nuk ka parë votën kur ka asistuar zgjedhësin. Respektimi i fshehtësisë kërkon, së pari, që zgjedhësi të ketë sigurinë se nuk po kontrollohet nga operatorit përgjatë votimit dhe, së dyti, që zgjedhësit e pranishëm në sallë të konstatojnë qartësisht dhe me bindje, se operatorit po bën gjithçka për të ruajtur shenjtërinë e fshehtësisë së votimit. Në të 5 rastet e paraqitura, kjo siguri mungon. Gjithsesi, nga këqyrja e pamjeve video krijohet bindja se në 2 raste është cenuar fshehtësia e votimit nga operatorit dhe në 1 rast është respektuar ajo. Për 2 rastet e tjera nuk mund të konkludohet me bindje.
22. Pretendimi se “*operatori shkon në krah të votuesit kur ai voton*” është ngritur në 44 raste. Rregullat i kërkojnë operatorit që të asistojë zgjedhësit kur kryejnë procedurat e votimit elektronik. Përgjatë këtij procesi operatorit është i detyruar të respektojë fshehtësinë e votimit.

Respektimi i fshehtësisë së votimit nuk mund të konsiderohet i plotësuar vetëm me ushtrimin e vetkontrollit nga ana e operatorit. Nuk mjafton që ai vetë të ketë ndërgjegjen e qetë, se nuk ka parë votën kur ka asistuar zgjedhësin. Respektimi i fshehtësisë kërkon, së pari, që zgjedhësi të ketë sigurinë se nuk po kontrollohet nga operatori përgjatë votimit dhe, së dyti, që zgjedhësit e pranishëm në sallë të konstatojnë qartësisht dhe me bindje, se operatori po bën gjithshka për të ruajtur shenjtërinë e fshehtësisë së votimit. Nga këqyrja e pamjeve video krijohet bindja se në 9 raste është cënuar fshehtësia e votimit nga operatori, në 15 raste mund të jetë cënuar fshehtësia e votimit nga operatori, në 18 ajo mund të mos jetë cënuar dhe në 2 raste është respektuar ajo.

23. Pretendimi se është kryer votim i asistuar në kundërshtim me procedurën ligjore është ngritur në 8 raste. Pamjet video provojnë se ky lloj votimi është përdorur kundrejt 12 personave. Për 5 persona, votimi i asistuar është kryer nga anëtarët e komisionit, gjë që përbën cënim të pikës 4 të nenit 108 të Kodit Zgjedhor, e cila përcakton se “anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve dhe sekretari nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë”. 7 personat e tjerë janë asistuar, me gjasë, nga të afërmit e tyre. Në 2 raste krijohet bindja se është shkelur procedura e dokumentimit të votimit të asistuar (deklarata në librin e protokollit e asistuesit sipas pikës 3 të nenit 108), kurse në 4 raste nuk mund të konkludohet me bindje. Në një rast provohet se një zgjedhës ka asistuar 3 votues, në 1 rast komisioneri ka asistuar 2 persona, kur ligji nuk lejon askënd që të asistojë më shumë se një votues.
24. Pretendimi në 2 raste se “operatori po kryen procedurë votimit i vetëm” bazohet në keqkuptimin e ankuesit për procesin e votimit elektronik dhe nevojën për të rizgjuar pajisjen, kur ajo kalon në *standby* nga mospërdorimi për më shumë se 5 minuta.
25. Të gjitha shkeljet e identifikuara nga provat video janë shkelje që ndiqen individualisht në kuadër të hetimit penal (neni 327 i Kodit Penal “Shkelja e fshehtësisë së votimit”) ose të hetimit të denoncimeve me karakter administrativ. Si episode shkeljesh, në kuadër të shqyrtimit të kërkesës për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore, ato nuk plotësojnë kushtin e masës kritike që kërkon neni 160 i Kodit Zgjedhor dhe jurisprudenca zgjedhore.
26. Sa i takon pretendimeve për ushtrimin e detyrës së komisionerit apo operatorit në kushtet e papajtueshmërisë, apo të përdorimit të punonjësve të administratës ditën e zgjedhjeve pranë

qendrave të votimit për të intimiduar ose shoqëruar zgjedhës të caktuar, ankuesi nuk solli prova për të faktuar pretendimin, apo për të faktuar se ishin zbatuar pa sukses procedurat mbrojtëse që parashikon ligji në këto raste, sikurse nuk solli prova lidhur me masën e ndikimit të secilit prej rasteve të denoncuar në mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Pretendimet për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të jenë konkrete, të faktueshme, të provueshme dhe të matshme. Të tilla këto pretendime nuk ishin të tilla në tërësinë e tyre.

27. Pretendimet e tjera të parashtruara në kërkesën ankimore nuk u ndoqën nga ankuesi përgjatë shqyrtimit të ankimit. Ankuesi nuk i ngriti, nuk paraqiti prova në mbështetje të tyre dhe nuk bazoi kërkime mbi to deri në përfundim të shqyrtimit. Prandaj KAS-i nuk sheh motiv ligjor për të analizuar dhe vendosur mbi to.
28. Lidhur me pretendimin e ankuesit “Lëvizja e Legalitetit” për deklarimin të rregullt të kutive për qendrat e votimit nr. 1575 dhe nr. 1597/02 dhe përfshirjen e rezultatit në tabelën përmbledhëse të zonës zgjedhore, KAS-i konstatoi nga këqyrja e jashtme e kutive të votimit për këto dy qendra votimit, se 3 nga 4 kutitë shoqëruese me fletët e votimit nuk kishin kodin e sigurisë që mbyll portën e printerit, kurse kutia e katërt nuk ishte përdorur për votim. Kjo gjendje fakti e vendos KZAZ-në përpara detyrimit që të deklarojë 3 kutitë të parregullta, sipas shkronjës “gj” të pjesës II Numërimi, të “Rregullave procedurale teknike për procesin e votimit elektronik nëpërmjet pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik në Bashkitë Vorë, Kamëz dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.
29. KAS-i nuk gjeti shkelje në këtë procedurë, por Kodi Zgjedhor parasheh mundësinë që këto kuti të hapen në procedurë ankimore. Pika 4 e nenit 138 përcakton se *“kur objekt i ankimit janë kutitë e votimit, të konstatuara si “KUTI TË PARREGULLTA” nga KZAZ-ja..., KQZ-ja është e detyruar të kryejë hetim administrativ gjatë shqyrtimit të ankesës për atë zonë zgjedhore, sipas nenit 124 të këtij Kodi. Hetimi nuk kufizohet vetëm në këqyrjen nga jashtë të kutisë, duke vlerësuar në tërësi faktet dhe rrethanat që kanë çuar në konstatimin e kutisë si “KUTI E PARREGULLT”, por edhe nëse këto parregullsi kanë ndikuar në materialin zgjedhor. Nëse KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjektit zgjedhor, shprehet me vendim se janë kuti të rregullta, KQZ-ja kryen numërimin fillestar të votave në këto kuti”*.

30. KAS-i vendosi hapjen dhe numërimin fillestar të këtyre votave, me arsyetimin se në kushtet e votimit elektronik, numërimin i votave dhe rakordimi i plotë i rezultatit me rezultatin e përmbledhëses së votimit që gjendet në kuti (printimi i rezultatit të votimit elektronik, i nxjerrë dhe që i është vënë në dispozicion subjekteve, përpara se printeri të çmontohej nga kutia) provojnë jashtë çdo lloj dyshimi se integriteti i kutisë nuk është prekur. Kur këto shifra rakordojnë, kutia duhet të deklarohet e rregullt dhe rezultati duhet të përfshihet në tabelën përmbledhëse. Hetimi provoi këtë hipotezë. Për këtë arsye, KAS-i vendosi që të përfshijë në tabelën përmbledhëse të rezultatit edhe rezultatin e QV-së nr. 1575 dhe të QV-së nr. 1597/02, si për kandidatët për kryetar bashkie, ashtu edhe për këshillin bashkiak.
31. Bazuar në këtë analizë ligjore dhe faktike, KAS-i duhet të rrëzojë kërkesën për pavlefshmërinë e zgjedhjeve për kryetar bashkie në zonën zgjedhore bashkia Kamëz, si të pa mbështetur në ligj dhe të pranojë kërkesën për përfshirjen e rezultatit të dy QV-ve në tabelën përmbledhëse.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” dhe 143, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me shumicë votash

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 81, datë 23.05.2023 të paraqitur nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 86, datë 25.05.2023 të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”.
3. Ndryshimin e vendimit nr. 536, datë 20.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë Kamëz, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023” sipas tabelës përmbledhëse të miratuar me vendimin e ndërmjetëm të KAS të datës 01.06.2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më 07.06.2023.

Elvin	LAKO	-	Relator	
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar	(Pjesërisht kundër)
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar	
Koli	BELE	-	Anëtar	
Ledio	BRAHO	-	Anëtar	(Pjesërisht kundër)

MENDIM PAKICE

Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 81, datë 23.05.2023 të paraqitur nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 536, datë 20.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë dhe për këshillin e bashkisë në zonën zgjedhore bashkia Kamëz, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023” dhe pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore bashkia Kamëz”, ne anëtarët në pakicë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e ankimit në fjalë, ndaj paraqesim në vijim argumentet tona për këtë qëndrim:

1. Ne, anëtarët në pakicë, vlerësojmë se KAS në këtë vendimmarrje nuk ka arritur në një konkluzion të drejtë kryesisht për shkakun se administrata e KQZ dështoi në vendosjen në dispozicion të subjektit ankimues në mënyrë të plotë dhe brenda një kohe të arsyeshme të informacioneve dhe pamjeve filmike të qendrave të votimit, duke e privuar në këtë mënyrë atë nga mundësia për grumbullimin dhe paraqitjen e provave të plota të nevojshme për vërtetimin e pretendimeve të parashtruara në këtë kërkesë ankimore.
2. Administrimi i plotë i të gjitha provave është i një rëndësie të dorës së parë në funksion të një hetimi të gjithanshëm të të gjithë elementëve të kërkesës ankimore, aq më tepër kur në kërkesë ngrihen pretendime që bazohen në dyshime të arsyeshme, disa të vërtetuara edhe në seancën e zhvilluar në KAS, për ekzistencën e problematikave serioze në procesin e votimit në këtë bashki.
Konkretisht:

- ndryshimet në programimin e procesit të printimit të votës nga Pajisjet Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN) në kundërshtim me karakteristikat teknike të përcaktuara në pikën 10/k të vendimit të Komisionit Rregullator në KQZ nr. 4, datë 13.11.2020, fakt i cili u vërtetua gjatë hetimit administrativ të bërë në KAS;
- mosfunksionimi sipas parashikimit i një pjese të madhe të kamerave të vendosura në qendrat e votimit;

- shoqërimi i votuesve nga operatorët e pajisjes elektronike të votimit, nga ana e komisionerëve ose punonjësve të administratës vendore dhe qendrore, pa respektuar procedurën ligjore / fenomen që evidentohet qartë nga pamjet filmike të kqyrura;
- pretendimi për lejimin e votimit familjar në disa raste;
- pretendimi për ekzistencën e konfliktit të interesit të administratës zgjedhore në raport me njërin prej kandidatëve për kryetar bashkie;
- prezenca e personave të paautorizuar dhe në marrëdhënie pune me kandidatin e PS në ambientet e qendrave të votimit duke intimiduar dhe ushtruar presion ndaj votuesve;

Në këto rrethana, do të duhej të bëhej një analizë më e plotë e të gjithë elementeve të cituar më sipër të cilët mund të kenë ndikuar në formësimin e vullnetit të zgjedhësve apo pengimin e tyre për të votuar në fshehtësi. Moskryerja e një hetimi të gjithanshëm, nuk ndihmon aspak në bërjen e transparencës të procesit zgjedhor.

- Idea e drejtësisë zgjedhore duhet të respektohet gjatë gjithë kohës kur përcaktohet se cila palë ka barrën për të provuar një fakt ose pretendim specifik dhe si paraqiten provat gjatë shqyrtimit administrativ. Për shkak të natyrës komplekse dhe politike të çështjeve të lidhura me proceset zgjedhore, procesi me të cilin barra e provës u ndahet palëve duhet të përcaktohet qartë paraprakisht kur paraqiten çështjet dhe shpërndarja e barrës midis palëve duhet të jetë e drejtë, pa ngarkuar njërin palë të mbajë të gjithë peshën e provës kur një çështje paraqitet për shqyrtim administrativ.
- Pavlefshmëria e zgjedhjeve është mjet ligjor në dispozicion të subjekteve ankuese, i cili mundëson anulimin e votimit/rezultatit dhe përsëritjen e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi. Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si shkaqe për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve: a) shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor ose tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Pra Kodi Zgjedhor njeh si shkak për pavlefshmërinë një tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat ose mund të kenë cënuar rëndë procesin zgjedhor ose tërësia e tyre është verifikuar në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore.

5. Si rregull kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen me provën që vërteton se shkelja e pretenduar është *“shkelje që cënon rëndë procesin zgjedhor”* apo *“të ketë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve”* dhe çështja e provueshmërisë së këtyre shkeljeve ligjore të pretenduara nga ankimuesit është e një rëndësie themelore, në mënyrë që KAS të dalë me një vendim të drejtë lidhur me objektin e ankimit. Por, përpara se të arrihet në konkluzionin që shkeljet e evidentuara nuk formojnë *“shkelje që cënon rëndë procesin zgjedhor”*, apo që këto shkelje nuk mund të provohet se kanë ndodhur ose që kanë pasur ndikim mbi zgjedhësit për tjetërsimin e votës, fillimisht duhet të ndalemi në analizën e faktit nëse ankimuesi kishte mundësi objektive, në kushtet aktuale, që të siguronte provat në mënyrën e duhur. Edhe kjo analizë gjithashtu nuk mund të bëhet kurrësesi duke mos i dhënë ankuesit një kohë të arsyeshme për tu pajisur dhe për të vlerësuar të gjitha pamjet filmike të qendrave të votimit ku ai kishte indicie që ka pasur shkelje serioze të Kodit Zgjedhor, në funksion të përpunimit dhe evidentimit të provave të pretenduara.
6. Është fakt i ditur botërisht se ankuesi e ka të pamundur për ta aksesuar apo siguruar prova konkrete brenda afatit 5 ditor për depozitimin e kërkesave ankimore. Duhet pasur gjithashtu në konsideratë fakti se provimi me dokumentacion i ngjarjeve të pretenduara nga ana e ankimuesit, është një proces pothuajse i pamundur për sa kohë subjektet politike nuk janë *“ente shtetërore”* të veshura me autoritet shtetëror që të mund të dokumentojnë (nëpërmjet mbajtjes së procesverbaleve të konstatimit etj.) apo të prodhojnë akte, që të mund të shërbejnë në një moment të dytë si provë shkresore të kryerjes së një veprimi të kundërligjshëm. Pikërisht kjo është arsyeja se ankimuesi koalicioni Bashkë Fitojmë, në këtë rast është në pamundësi objektive të sigurimit të provës në mënyrën e kërkuar.
7. Nenet 124 – 144 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë procedurën që ndjek Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve për shqyrtimin e një ankimi administrativ. Neni 136, pika 1, gërma *“c”* parashikon se palët kanë të drejtë të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre. Gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës ankimore në fjalë, u provua se ankimuesi e kishte të pamundur të administronte brenda një kohe të kufizuar të vënë në dispozicion të gjitha provat për shkeljet e pretenduara. Mjafton të

sjellim në vëmendje faktin se përgjigjet për pyetjet e drejtuara nga ankimesi kompanisë që administron PEVN, u dorëzuan vetëm në seancën e fundit të shqyrtimit të kërkesës ankimore në KAS, ndonëse pyetjet i ishin dorëzuar administratës së KQZ prej disa ditësh në formë të shkruar. Për ne anëtarët e pakicës, kjo qasje kundrejt ankimesit ka sjellë si pasojë një vendimmarrje që nuk pasqyron produktin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të asaj se çka subjekti ankimes pretendoi gjatë shqyrtimit administrativ. Në këtë mënyrë shumica e anëtarëve të KAS, me anë të vendimmarrjes së tyre përfundimtare, ka anashkaluar krejtësisht në mënyrë të pajustificuar tërësinë e elementëve/fenomenëve (të cilat ankuesi i konsideron shkelje flagrante të ligjit) të cilat mund të kenë ose kanë ndikuar drejtpërdrejt në deformimin e vullnetit të zgjedhësve gjatë procesit të votimit.

8. Në nenin 160 të Kodit Zgjedhor, parashikohen edhe rastet e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi. Në mënyrë që të analizohet në themel kjo dispozitë dhe të interpretohet në kuptimin qëllimor të saj, kërkohet një hetim të gjithanshëm mbi prova dhe një interpretim i Kodit Zgjedhor dhe të ligjit në përgjithësi (pasi neni 160 nuk kufizohet vetëm në shkelje të K.Zgjedhor), për të arritur në përfundimin nëse kemi të bëjmë me shkelje të tilla që pasjellin pavlefshmëri të zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi.
9. Potencialisht parregullsitë e denoncuar nga ankimesi, të analizuar si raste të izoluara, mund të mos përbëjnë në dukje shkak ligjor për të pasjellë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë të caktuar, por nëse e vlerësojmë këtë dukuri në këndvështrim të harmonizimit të të gjithë elementëve të kundërligjshëm të koordinuar paraprakisht, atëherë potencialisht ekziston një dyshim i arsyeshëm që graviteti i veprimtarisë së kundërligjshme të mund të ketë ndikuar në një mënyrë dhe masë të tillë në vullnetin e zgjedhësve sa që të mund të sjellë si pasojë pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Për sa kohë KAS nuk është në gjendje të verifikojë apo të konstatojë përmasën e këtyre “parregullsive procedurale”, atëherë afërmendsh që është në pamundësi të konkludojë drejt nëse këto shkelje formojnë ose jo parregullsi ligjore të tilla që të mund të sjellin pavlefshmërinë e zgjedhjeve.

10. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se për sa kohë hetimi administrativ kufizohet në mos administrimin dhe mos analizimin e të gjitha provave ku palët bazojnë pretendimet e tyre nuk u jep një përgjigje shteruese pyetjeve të përmendura më lart, vendimi i marrë me shumicën e votave të anëtarëve të KAS për rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 81, datë 23.05.2023 të subjektit zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” është një vendim i pabazuar në prova e në ligj.

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar



QARKU Tiranë
KZAZ NR 27

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE
Për kandidatët për kryetar të Bashkisë



1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr 1564/00	QV nr 1564/01	QV nr 1565/00	QV nr 1565/01	QV nr 1566/00	QV nr 1567/00	QV nr 1567/01	QV nr 1568/00	QV nr 1568/01	QV nr 1569/00	QV nr 1569/01	QV nr 1570/00	QV nr 1570/01	QV nr 1571/00	QV nr 1571/01	QV nr 1572/00	QV nr 1572/01	
2	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej	344	288	347	318	268	377	350	299	257	398	372	296	236	440	465	432	396
		gra	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Fletë votimi të papërdorura	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Fletë votimi të dëmtuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
5	Fletë Votimi të gjetura në kuti	344	288	347	318	268	377	350	299	257	398	372	296	236	440	465	432	396	
6	Vota të pavlefshme	4	1	4	5	2	9	5	5	2	9	3	3	4	9	1	7	17	
7	Vota të vlefshme	340	287	343	313	266	368	345	294	255	389	369	293	232	431	464	425	379	
8	Fletë votimi të hedhura gabim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, atësia, mbiemri)	QV nr 1564/00	QV nr 1564/01	QV nr 1565/00	QV nr 1565/01	QV nr 1566/00	QV nr 1567/00	QV nr 1567/01	QV nr 1568/00	QV nr 1568/01	QV nr 1569/00	QV nr 1569/01	QV nr 1570/00	QV nr 1570/01	QV nr 1571/00	QV nr 1571/01	QV nr 1572/00	QV nr 1572/01
1	Rakip Bajram Suli	189	155	208	188	159	231	236	177	139	207	209	195	151	252	328	282	244
2	Bilbil Mehdi Bajraktari	17	14	16	12	11	17	7	9	5	11	16	14	6	9	11	13	13
3	Arjan Xhavit Hoxha	134	118	119	113	96	120	102	108	111	171	144	84	75	170	125	130	122
	Gjithsej vota të vlefshme	340	287	343	313	266	368	345	294	255	389	369	293	232	431	464	425	379

Kryetar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Zv/Kryetar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Faqja 1

ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

Model: KQZ-00-29 i miratuar me udhëzim të Komisionerit nr.2 datë 13.04.2023



QARKU Tiranë
KZAZ NR 27

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE
Për kandidatët për kryetar të Bashkisë



1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr 1572/02	QV nr 1573/00	QV nr 1573/01	QV nr 1573/02	QV nr 1573/03	QV nr 1573/04	QV nr 1574/00	QV nr 1574/01	QV nr 1575/00	QV nr 1575/01	QV nr 1575/02	QV nr 1576/00	QV nr 1576/01	QV nr 1577/00	QV nr 1577/01	QV nr 1577/02	QV nr 1578/00
2	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	404	438	335	416	403	369	400	359	337	361	348	373	338	428	391	410	432
	gjithsej	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	gra	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Fletë votimi të papërdorura	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Fletë votimi të dëmtuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
5	Fletë Votimi të gjetura në kuti	404	438	335	416	403	369	400	359	337	361	348	373	338	428	391	410	432
6	Vota të pavlefshme	8	15	14	9	12	5	11	11	7	13	10	11	6	5	7	6	13
7	Vota të vlefshme	396	423	321	407	391	364	389	348	330	348	338	362	332	423	384	404	419
8	Fletë votimi të hedhura gabim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, atësia, mbiemri)	QV nr 1572/02	QV nr 1573/00	QV nr 1573/01	QV nr 1573/02	QV nr 1573/03	QV nr 1573/04	QV nr 1574/00	QV nr 1574/01	QV nr 1575/00	QV nr 1575/01	QV nr 1575/02	QV nr 1576/00	QV nr 1576/01	QV nr 1577/00	QV nr 1577/01	QV nr 1577/02	QV nr 1578/00
1	Rakip Bajram Suli	235	186	121	170	177	174	194	164	135	166	173	207	188	305	264	248	247
2	Bilbil Mehdi Bajraktari	18	27	17	22	15	10	14	20	4	5	11	14	19	16	12	16	22
3	Arjan Xhavit Hoxha	143	210	183	215	199	180	181	164	191	177	154	141	125	102	108	140	150
	Gjithsej vota të vlefshme	396	423	321	407	391	364	389	348	330	348	338	362	332	423	384	404	419

Kryetar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Zv/Kryetar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Faqja 2

ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023



QARKU Tiranë
KZAZ NR 27

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE
Për kandidatët për kryetar të Bashkisë



1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr 1578/01	QV nr 1579/00	QV nr 1579/01	QV nr 1579/02	QV nr 1579/03	QV nr 1580/00	QV nr 1580/01	QV nr 1581/00	QV nr 1581/01	QV nr 1581/02	QV nr 1582/00	QV nr 1582/01	QV nr 1583/00	QV nr 1583/01	QV nr 1584/00	QV nr 1584/01	QV nr 1585/00
2	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	377	412	363	408	370	294	266	420	401	462	329	356	232	228	341	338	323
	gjithsej	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	gra	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Fletë votimi të papërdorura	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Fletë votimi të dëmtuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
5	Fletë Votimi të gjetura në kuti	377	412	363	408	370	294	266	420	401	462	329	356	232	228	341	338	323
6	Vota të pavlefshme	4	14	19	15	19	7	8	14	14	8	13	10	10	3	4	2	7
7	Vota të vlefshme	373	398	344	393	351	287	258	406	387	454	316	346	222	225	337	336	316
8	Fletë votimi të hedhura gabim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, atësia, mbiemri)	QV nr 1578/01	QV nr 1579/00	QV nr 1579/01	QV nr 1579/02	QV nr 1579/03	QV nr 1580/00	QV nr 1580/01	QV nr 1581/00	QV nr 1581/01	QV nr 1581/02	QV nr 1582/00	QV nr 1582/01	QV nr 1583/00	QV nr 1583/01	QV nr 1584/00	QV nr 1584/01	QV nr 1585/00
1	Rakip Bajram Suli	215	228	205	242	183	166	154	304	248	300	171	188	100	120	206	209	190
2	Bilbil Mehdi Bajraktari	6	12	15	10	16	13	10	19	18	19	11	10	9	5	8	5	8
3	Arjan Xhavit Hoxha	152	158	124	141	152	108	94	83	121	135	134	148	113	100	123	122	118
	Gjithsej vota të vlefshme	373	398	344	393	351	287	258	406	387	454	316	346	222	225	337	336	316

Kryetar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Zv/Kryetar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Faqja 3

ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

Model: KQZ-00-29 i miratuar me udhëzim të Komisionerit nr.2 datë 13.04.2023



QARKU Tiranë
KZAZ NR 27

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE
Për kandidatët për kryetar të Bashkisë



1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr 1585/01	QV nr 1586/00	QV nr 1586/01	QV nr 1586/02	QV nr 1587/00	QV nr 1587/01	QV nr 1588/00	QV nr 1588/01	QV nr 1588/02	QV nr 1589/00	QV nr 1589/01	QV nr 1589/02	QV nr 1590/00	QV nr 1591/00	QV nr 1591/01	QV nr 1592/00	QV nr 1592/01
2	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	324	398	403	427	327	304	417	341	330	419	420	367	410	252	251	355	336
	gjithsej	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	gra	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Fletë votimi të papërdorura	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Fletë votimi të dëmtuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
5	Fletë Votimi të gjetura në kuti	324	398	403	427	327	304	417	341	330	419	420	367	410	252	251	355	336
6	Vota të pavlefshme	1	4	19	7	3	10	10	11	6	14	9	12	7	7	7	4	8
7	Vota të vlefshme	323	394	384	420	324	294	407	330	324	405	411	355	403	245	244	351	328
8	Fletë votimi të hedhura gabim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, atësia, mbiemri)	QV nr 1585/01	QV nr 1586/00	QV nr 1586/01	QV nr 1586/02	QV nr 1587/00	QV nr 1587/01	QV nr 1588/00	QV nr 1588/01	QV nr 1588/02	QV nr 1589/00	QV nr 1589/01	QV nr 1589/02	QV nr 1590/00	QV nr 1591/00	QV nr 1591/01	QV nr 1592/00	QV nr 1592/01
1	Rakip Bajram Suli	166	234	234	261	193	196	209	141	168	229	214	192	283	137	163	173	176
2	Bilbil Mehdi Bajraktari	13	15	8	18	20	18	31	35	15	24	19	14	14	17	6	11	13
3	Arjan Xhavit Hoxha	144	145	142	141	111	80	167	154	141	152	178	149	106	91	75	167	139
	Gjithsej vota të vlefshme	323	394	384	420	324	294	407	330	324	405	411	355	403	245	244	351	328

Kryetar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Zv/Kryetar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Faqja 4

ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023



QARKU Tiranë
KZAZ NR 27

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE
Për kandidatët për kryetar të Bashkisë



1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr 1593/00	QV nr 1593/01	QV nr 1594/00	QV nr 1594/01	QV nr 1595/00	QV nr 1595/01	QV nr 1596/00	QV nr 1596/01	QV nr 1597/00	QV nr 1597/01	QV nr 1597/02	QV nr 1598/00	QV nr 1598/01	QV nr 1599/00	QV nr 1599/01	QV nr 1599/02	QV nr 1600/00
2	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	241	263	201	280	360	345	373	366	372	346	330	400	383	283	316	316	482
	gjithsej	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	gra	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Fletë votimi të papërdorura	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Fletë votimi të dëmtuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
5	Fletë Votimi të gjetura në kuti	241	263	201	280	360	345	373	366	372	346	330	400	383	283	316	316	482
6	Vota të pavlefshme	7	3	4	7	5	11	12	9	8	4	12	4	13	3	4	4	9
7	Vota të vlefshme	234	260	197	273	355	334	361	357	364	342	318	396	370	280	312	312	473
8	Fletë votimi të hedhura gabim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, atësia, mbiemri)	QV nr 1593/00	QV nr 1593/01	QV nr 1594/00	QV nr 1594/01	QV nr 1595/00	QV nr 1595/01	QV nr 1596/00	QV nr 1596/01	QV nr 1597/00	QV nr 1597/01	QV nr 1597/02	QV nr 1598/00	QV nr 1598/01	QV nr 1599/00	QV nr 1599/01	QV nr 1599/02	QV nr 1600/00
1	Rakip Bajram Suli	144	162	106	123	242	191	163	150	224	219	175	231	262	170	190	214	302
2	Bilbil Mehdi Bajraktari	7	6	15	18	8	15	21	13	17	10	17	28	14	13	16	4	12
3	Arjan Xhavit Hoxha	83	92	76	132	105	128	177	194	123	113	126	137	94	97	106	94	159
	Gjithsej vota të vlefshme	234	260	197	273	355	334	361	357	364	342	318	396	370	280	312	312	473

Kryetar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Zv/Kryetar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)


Faqja 5

ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023



QARKU Tiranë
KZAZ NR 27

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE
Për kandidatët për kryetar të Bashkisë



1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr 1600/01	QV nr 1600/02	QV nr 1600/03	QV nr 1601/00								Fl. Vot. Gabim	Totali	Totali me fjalë
2	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	414	405	394	452								X X X	31748	TridhjetëNjëmijëShtatëqindDyzetëTetë
	gjithsej	0	0	0	0								X X X	0	Zero
	gra	0	0	0	0								X X X	0	Zero
3	Fletë votimi të papërdorura	0	0	0	0								X X X	0	Zero
4	Fletë votimi të dëmtuara	0	0	0	0								X X X	0	Zero
5	Fletë Votimi të gjetura në kuti	414	405	394	452									31748	TridhjetëNjëmijëShtatëqindDyzetëTetë
6	Vota të pavlefshme	1	6	5	8									702	ShtatëqindDy
7	Vota të vlefshme	413	399	389	444									31046	TridhjetëNjëmijëDyzetëGjashtë
8	Fletë votimi të hedhura gabim	0	0	0	0								X X X	0	Zero

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, atësia, mbiemri)	QV nr 1600/01	QV nr 1600/02	QV nr 1600/03	QV nr 1601/00								Fl. Vot. Gabim	Totali	Totali me fjalë
1	Rakip Bajram Suli	285	232	253	217									17957	ShtatëmbëdhjetëmijëNëntëqindPesëdhjetëShtatë
2	Bilbil Mehdi Bajraktari	12	19	12	12									1237	NjëmijëDyqindTridhjetëShtatë
3	Arjan Xhavit Hoxha	116	148	124	215									11852	NjëmbëdhjetëmijëTetëqindPesëdhjetëDy
	Gjithsej vota të vlefshme	413	399	389	444									31046	TridhjetëNjëmijëDyzetëGjashtë

Kryetar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Zv/Kryetar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Faja e Fundit

ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023